



**REPUBLIKA E KOSOVËS**



**KOMUNA E VUSHTRISË**

**PLANI I PUNËS I DREJTORISË PËR SHËRBIME PUBLIKE  
PËR VITIN 2011**

## Plani i punës për vitin 2011

Drejtoria për Shërbime Publike, është organ i Kuvendit të Komunës e cila zbaton Ligjet, Rregulloret me të cilat rregullohen Shërbimet Publike, prandaj mbështetur në programin e punës së Kuvendit dhe organeve tjera, ka përgatitur Planin e punës për vitin 2011. Drejtoria për Shërbime Publike bënë rregullimin e qytetit dhe mbrojtjen e ambientit, bënë mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale të asfaltuara dhe të rendit të katërt, rregullimin e qarkullimit të komunikacionit, sinjalizimin horizontal dhe vertikal, parkingjet, transportin lokal, përcjellë procedurën e pastrimit të ujërave atmosferike nga sipërfaqet publike, mbikëqyrë punën e lëmisë së furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të zeza, menaxhon me procedurat e bartjes dhe deponimit të hedhurinave, pastrimin dhe larjen e rrugëve, shesheve dhe sipërfaqeve publike, mirëmbajtjen e shtratit të lumenjve, mirëmbajtjen e ndriçimit publik, mirëmbajtjen e varrezave, mbikëqyrë dhe menaxhon punën e autoparkut të Kuvendit Komunal, etj.

Në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike bëjnë pjesë:

- **Spektori për komunikacion (mirëmbajtje e rrugëve dhe transportit lokal)**
- **Spektori për Shërbime Komunale Publike**

**Në tabelat e mëposhtme është paraqitur në mënyrë të detajuar plani i punës së Drejtorisë për Shërbime Publike.**

### Spektori për komunikacion dhe lidhje

Nr.	Përmbajtja e punëve	Bartësi i punëve	Bashkëpunimi me subjektet	Afati i kryerjes	Vërejtje
1	Përgatitja dhe dhënia e Rendeve të udhëtimit, kompanive transportuese për bartjen publike të udhëtarëve. Planifikimi i vijave dhe orarit.	Spektori për komunikacion dhe lidhje	Bashkëpunimi me kompanitë transportuese, Inspeksionin, Policinë e Kosovës	Janar	
2	Reduktimi dhe sistemimi i kombibusëve si dhe vendosja e tyre në ndonjë vend parkim.	Spektori për komunikacion dhe lidhje	Bashkëpunimi me pronarët e kombibusëve, Inspeksionin dhe Policinë e Kosovës	Shkurt-Mars	
3	Vendosja e numrave të shtëpive.	DSHP		Prill	
4	Analiza dhe plotësimi i disa senseve (kaheve) të lëvizjes në disa rrugë të qytetit, në bazë të kërkesave të qytetarëve.	Spektori për komunikacion dhe lidhje	Bashkëpunimi me hartuesit e kërkesave	Prill-Maj	
5	Përcaktimi dhe definimi i senseve (kaheve) të lëvizjes së automjeteve në rrugët e qytetit në të cilat ende nuk është përcaktuar.	Spektori për komunikacion dhe lidhje	Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës	Maj-Qershor	

6	Planifikimi i sinjalizimit horizontal dhe ndriqimit publik në rrugët që do të ndërtohen në vitin 2011.	Spektori për Komunikacion dhe lidhje dhe Spektori për Sherbime Publike Komunale	Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës	Gjatë vitit	
7	Krijimi i hapësirave të mjaftueshme në trotuare për lëvizje të qytetarëve, idetë për ndërtimin dhe rregullimin e tyre si dhe largimin e pengesave.	Spektori për komunikacion dhe lidhje	Bashkëpunimi me Drejtorinë për Urbanizëm dhe Inspeksionin	Maj	
8	Incizimi, analizimi i madhësisë dhe dendësisë së qarkullimit në rrugët e qytetit për verifikim të senseve të lëvizjes.	Spektori për komunikacion dhe lidhje	Bashkëpunimi me nxënësit e Shkollës së Mesme Teknike, drejtimi i komunikacionit.	Maj	
9	Rregullimi dhe pajisja e rrugëve që kryqëzohen në nivel me hekurudhat me sinjalet adekuate.	Spektori për komunikacion dhe lidhje		Maj-Qershor	
10	Harmonizimi i akteve normative me Ligjin për Sigurinë në Komunikacion, Ligjin për Rrugët, Ligjin për transportin etj.	Spektori për komunikacion dhe lidhje		Qershor	
11	Mirëmbajtja e rrugëve të asfaltuara, në rrugët lokale	Spektori për komunikacion	Bashkëpunimi me Drejtorinë e urbanizmit	Qershor	
12	Rregullimi i parkingjeve dhe krijimi i hapësirave, mundësive sa më të mëdha, për parkim të automjeteve	Spektori për komunikacion	Bashkëpunimi me Drejtorinë e Urbanizmit, Gjeodezisë dhe Kadastrat	Korrik-Gusht	
13	Mirëmbajtja e vendndalimeve për autobusë	Spektori për komunikacion		Gjatë vitit	
14	Mirëmbajtja e rrugëve të rendit ë katërt.	Spektori për komunikacion		Gusht	

15	Mbikëqyrja e rrugëve dhe mirëmbajtja e sinjaleve rrugore në rrugët lokale të Komunës.	Sektori për komunikacion	Bashkëpunimi me Inspeksionin	Guht-Shtator	
16	Punë të ndryshme administrative për përgatitjen dhe organizimin e kompanive për transportin publik gjatë vitit shkollor.	Sektori për komunikacion	Bashkëpunimi me kompanitë për transportin publik, inspeksionin.	Gusht-Shtator	
17	Përgatitja dhe mobilizimi për punë sa më efektive të kompanive gjatë sezonës së dimrit.	Sektori për komunikacion	Bashkëpunimi me kompanitë për transportin publik	Tetor	
18	Përgatitja për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve	Sektori për komunikacion		Nëntor	
19	Përgatitja për vazhdimin e rrezeve të udhëtimit për punë të kompanive transportuese dhe taksi shërbimeve, duke përfshirë edhe vijat dhe oraret për vitin 2010.	Sektori për komunikacion dhe lidhje	Bashkëpunimi me kompanitë për transportin publik	Dhjetor	
20	Përgatitja dhe analizimi i gjendjes së transportit të udhëtarëve me automjete (8+1 ulëse)	Sektori për komunikacion dhe lidhje	Bashkëpunimi me Shoqatën e Kombibusëve.	Dhjetor	
21	Shqyrtimi i Raportit të punës të sektorit të komunikacionit dhe përgatitja e planit për vitin vijues	Sektori për komunikacion dhe lidhje		Dhjetor	
22	Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të K. Komunës	Sektori për komunikacion	Bashkëpunimi me Drejtorinë e Buxhetit dhe Prokurimit	Gjatë tërë vitit, sipas nevojë	
23	Sigurimi dhe regjistrimi i automjeteve të K. Komunës	Sektori për komunikacion	Bashkëpunimi me Drejtorinë e Buxhetit dhe Prokurimit	Sipas datave të skadimit	

## Sektori për Shërbimet Komunale Publike

Numri Rendor	Përmbajtja e punëve	Bartësi i punëve	Bashkëpunon me subjektet	Afati i kryerjes	Vërejtje
1.	Furnizimi qytetarëve me ujë të pijshëm	Drejtoria për Shërbime Publike	Bashkëpunon me Kompaninë Regjionale Ujësjiellësi Regjional në Mitrovicë dhe njësi në Vushtrri, dhe Komunitetin	Gjatë tërë vitit	
2	Përkrahja teknike dhe financiare(furnizim me gypa) e iniciativave të qytetarëve për ndërtimin e rrjetave primare dhe sekondare të ujësjiellësve	Drejtoria për Shërbime Publike ajo për Urbanizëm	Drejtorinë për Urbanizëm, Drejtorinë për zhvillim, Komuniteti, Ujësjiellësi regjional, Donatorët.	Gjatë vitit tërë	
3	Urdhëresa për racionalizimin e përdorimit të ujit të pijshëm gjatë periudhës 15 prill-31 tetor 2011.	Drejtoria për Shërbime Publike UR “Mitrovica”	Kuvendin Komunal Drejtorin e Administratës dhe Personelit dhe Drejtorin për Inspeksion	Prill	
4	Ndërtimi i kanalizimit të ujërave të zeza, sipas planit për vitin 2011.	Drejtoria për Shërbime Publike UR “Mitrovica”	Drejtorinë për Urbanizëm, Drejtorinë për Ekonomi e zhvillim, Drejtoria për Prokurim dhe Drejtorinë për Buxhet	Qershor-Korrik	
5	Përkrahja teknike dhe financiare(furnizim me gypa) e iniciativave të qytetarëve për ndërtimin e rrjetave primare dhe sekondare të kanalizimeve nëpër fshatra dhe qytet.	Drejtoria për Shërbime Publike UR “Mitrovica” Drejtoria për Urbanizëm	Këshillin iniciativë të komunitetit, Drejtoria për zhvillim, K. Komunal, Ujësjiellësin Rajonal dhe Donatorët eventual.	Gjatë tërë Vitit	

6	Debllokimi i ujëmbledhësve dhe i kanalizimit atmosferik	Drejtoria për Shërbime Publike	Drejtorinë për Buxhet , Drejtoria për Prokurimit	Gusht	
7	Plani i fshirje – larjes së rrugëve në qytet. 01.01.2011– 31.12.2011.	Drejtoria për Shërbime Publike Drejtoria për Inspeksion	Drejtoria për Prokurim dhe Drejtoria për Buxhet Sektori për komunikacion Drejtoria për Inspeksion	Janar	
8	Plani i zgjerimit të veprimit të KRRH “Uniteti” SH.A. në qytet dhe nëpër fshatra të komunës	Kompania “Uniteti” Njësia Operative në Vushtri	Drejtorinë për Shërbime Publike, Komuniteti, Inspektori e ambientit dhe ai komunal.	Gjatë tërë vitit	
9	Mirëmbajtja e shtratit të lumit “Tërstena” në Vushtri	Drejtoria për Shërbime Publike	Drejtoria për Ekonomi e zhvill. Drejtoria për Prokurim dhe Drejtoria për Buxhet	Gjatë tërë vitit	
10	Mirëmbajta e ndriçimit publik në qytet.	Drejtoria për Shërbime publike	Drejtoria për Prokurim Drejtorinë për Buxhet KEK njësia Vushtri	Gjatë tërë vitit	
11	Mirëmbajtja e varrezave të qytetarëve, martirëve dhe dëshmorëve.	Drejtoria për Shërbime Publike Inspektori sanitar	Drejtoria për Prokurim, Drejtorinë për Buxhet, Drejtoria për urbanizëm dhe mjedis.	Gjatë tërë vitit	
12	Mirëmbajtja e parqeve dhe gjelbërimit	Drejtoria e Shërbimeve publike	Drejtorinë për Buxhet Drejtorinë për Ekonomi dhe Zhvillim Inspektori i mjedisit	Gjatë tërë vitit	
13	Plani i Aktiviteteve për shënimin e muajit të higjienës	Inspektori i mjedisit Inspektori komunal Drejtoria për SHP	Drejtoria për Prokurim Drejtorinë për Buxhet Drejtoria për urbanizëm .	Prill	
14	Përgatitja e Raportit për vitin 2011 dhe përgatitja e Planit për vitin 2012	Drejtoria për Shërbime Publike		Dhjetor	